

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore, TM4 2023

21.08.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM4 2023.

### Shkalla e papunësisë në Kosovë 11.8%

Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 173 978) janë popullsi në moshë pune (56 520 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Persona aktivë ishin 29 508 persona më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Persona joaktivë ishin 27 010 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Persona të punësuar ishin 8 789 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Persona të papunësuar ishin 38 298 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Tabela 1. Indikatorët kryesorë të Tregut të Punës TM4 2022 / TM4 2021

Indikatorët kryesorë të tregut të punës ('000)	TM4 2022			TM4 2021		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktivë) (15-64 vjeç)	328 033	124 279	452 312	344 968	136 852	481 820
Persona joaktivë (15-64 vjeç)	260 023	461 643	721 666	267 583	481 093	748 676
Të punësuar (15-64 vjeç)	298 813	100 121	398 934	286 218	103 927	390 145
Të papunësuar (15-64 vjeç)	29 220	24 158	53 378	58 751	32 925	91 676
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	6 413	3 583	9 996	14 324	9 635	23 959
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollim ose trajnim (NEET)	48 881	45 948	94 829	55 960	55 434	111 394
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	53 436	7 996	61 432	37 220	5 027	42 247
<b>Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)</b>						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	55,8	21,2	38,5	56,3	22,1	39,2
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	44,2	78,8	61,5	43,7	77,9	60,8
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	50,8	17,1	34,0	46,7	16,8	31,7
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	8,9	19,4	11,8	17,0	24,1	19,0
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	17,2	23,4	19,0	30,6	43,1	34,6
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	32,7	34,9	33,7	34,3	35,3	34,8
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	17,9	8,0	15,4	13,0	4,8	10,8

Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 4,1% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kurse, përqindja e femrave të punësuar ishte 0,3% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Shkalla e punësimit ishte 2,3% më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e papunësisë ishte më e ulët për (-7,2%) sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Kurse tek të rinjtë (15-24 vjeç), shkalla e papunësisë ishte më e ulët për (-15,6%) sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

### Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet e lartë

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaftë e lartë (61,5 %), duke u rritur me 0.6 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Shkalla e joaktivitetit tek femrat ishte shumë e theksuar 78.8 %, krahasuar me meshkujt, 44.2 %.

### Tregtia, ndërtimtaria dhe arsimiti prijnë me punësim

Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 18,7%, ndërtimtaria 12,1%, arsimiti me 10,3%, administrata publike dhe mbrojtja me 9,2%, prodhimi me 8,2%, etj.

Femrat ishin të punësuara, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 55,2% të tyre. Ndërsa, meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë, administratës publike dhe mbrojtjes, prodhimit, si dhe në sektorët e aktivitetit për akomodim dhe shërbim me ushqim, me 62,6%.

**Tabela 2. Të punësuarit sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik në TM4 2022, moshë 15+**

Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	3,4	1,2	2,9
B - Miniera dhe xeherore	1,0	1,1	1,0
C - Prodhim	9,2	5,0	8,2
D - Furnizim me energji, gaz, avull dhe klimatizim	3,2	0,4	2,5
E - Furnizim me ujë, ujëra të zeza, menaxhim i mbeturinave	1,2	0,4	1,0
F - Ndërtimtari	16,0	0,4	12,1
G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjeteve dhe motoçikletash	18,7	18,5	18,7
I - Aktiviteti i akomodimit dhe shërbime të ushqimit	9,1	6,7	8,5
H - Transport dhe depozitim	5,7	1,5	4,6
J - Informim dhe komunikim	2,3	3,4	2,5
K - Aktivitet financiar dhe sigurime	2,6	2,9	2,6
L - Aktivitet me pronë të paluajtshme	0,4	0,0	0,3
M - Aktivitet profesional, shkencor dhe teknik	2,1	1,9	2,0
N - Aktivitet administrativ dhe shërbime mbështetëse	2,9	5,5	3,6
O - Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social	9,6	7,8	9,2
P - Arsim	6,0	23,1	10,3
Q - Aktiviteti i shëndetit njerëzor dhe punë sociale	2,5	13,6	5,3
R - Art, zbavitje dhe rekreacion	1,3	0,7	1,1
S - Aktiviteti i shërbimeve të tjera	1,7	4,5	2,4
T - Aktiviteti i ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitet prodhues i mallrave dhe shërbime të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	0,1	0,2	0,1
U - Aktiviteti i institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	1,0	1,1	1,0
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>



Ky publikim ofron të dhëna statistikore për treguesit e tregut të punës bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP). Për realizimin e AFP-së, TM4 2022, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM4 2023 vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>